

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "KOPESHTI - LALA"
SHPK

Sot, me dt. 09.04.2006, une e nenshkuara Teuta Lala, e bija e Petritit, e dtl. 1966, lindur e banues ne Tirane, Rr Aleksander Moisiu, Vile Private, Konostudio, Tirane. me vullnetin e lire e te plote perpiloj kete akt themelimi.

Neni 1

Krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "KOPESHTI - LALA" SHPK .

Neni 2

Shoqeria deklarohet e krijuar nen ruajtjen e plote te normave qe permban ky akt.

Neni 3

Veprimtaria e shoqerise , marredheniet e saj me persona te trete juridik e fizik, vendas e te huaj,shteteror e privat,regullohen ne baze te ligjit nr 7638 dt.19.II.1992 "Per shoqerite tregtare " si dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te ketij ligji.

Shoqeria pergjigjet vetem per pasurine e saj.

Neni 4

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, Rr Aleksander Moisiu, Vile Private, Konostudio, Tirane.

Veprimtaria e shoqerise, emertimi e selia e saj ,te percaktuara ne kete akt themelimi , nuk mund te ndryshojne pa pelqimin e Ortakes se vetme te shoqerise.

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:


Hapje kopshte private.

Neni 7

Kapitali themeltare i shoqerise eshte 100.000 Leke i formuar nga kontributi i ortakes se vetme te shoqerise Teuta Lala.

Neni 8





Per nevoja te punes dhe te ushtrimit te aktivitetit te saj shoqeria mund te çele llogari ne çdo banke te njohur me ligj, qofte kjo private dhe shteterore.

Neni 9

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete mbi 10 vjet.Por ajo mund te ushtroje aktivitetin e saj edhe tej ketij afati me vendim te Ortakes se vetme te shoqerise. Gjithashtu shoqeria mund te shperndahet edhe perpara ketij afati per rastet e parashikuara ne ligj.

Neni 10

Pronare e vetme ei shoqerise “**KOPESHTI - LALA**” shpk eshte themeuesja e saj Teuta Lala dhe perfaqesuese e saj ligjore eshte administratorja e saj e vetme Teuta Lala.

Neni 11

Ortakja mban pergjegjesi vete per ruajtjen e karakterit te fshehtesise se aktivitetit dhe te dokumentacionit te shoqerise.

Neni 12

Organet e shoqerise jane:

1-Ortakja e vetme.

2-Administratorja.

Komisioni i eksperteve kontabel Modalitete e formimit dhe te funksionimit te tyre percaktohen ne statutin bashkangjitur.

Neni13


Per nevoja te punes kjo shoqeri mund te punesoje edhe punetor e specialist te ndryshem , me kontrata te rregullta pune sipas dispozitave ne fuqi.

Neni 14

Dispozita me te hollesishme per shoqerine percaktohen ne statutin bashkangjitur.

Neni 15

Ky akt themelimi u redaktua ne kater kopje, njera depozitohet ne noteri, nje ne zyren e regjistrimit tregtare prane gjykates rrethit Tirane, nje ne zyren e taksa tatimeve dhe nje ne dokumentacionin e shoqerise.





ORTAKE E VETME E SHOQERISE

TEUTA LALA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

NR. REP 11592


NR. KOL

VERTETIM

Ne Tirane, sot, me dt 30/12/ 2005 para meje noteres u paraqit personalisht Teuta Lala e Bija e Petritit, lindur dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te ciles u sigurova nga dokumenti perkates qe mbante me vehte e cila deklaroi se sa me siper eshte shprehur vullneti i saj i lire e i plote .

Pasi e nenshkruan rregullisht para meje noteres une e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE



NOTERE
Silvana Merko
Cel: 0682074214

**STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"KOPESHTI - LALA" SHPK**

Formimi
neni 1



Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "KOPESHTI - LALA" SHPK nga ORTAKE E VETME , Teuta LALA, lindur dhe banues ne Tirane, Rr Aleksander Moisiu, Vile Private, Konostudio, Tirane.

VENDQENDRIMI

Neni 2

Vendqendrimi i shoqerise do te jete ne Tirane, Rr Aleksander Moisiu, Vile Private, Konostudio, Tirane.

Shoqeria mund te hap filiale ne te gjithë teritorin e vendit .

KOHEZGJATJA

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete mbi 10 vjet .Por shoqeria mund te zgjase kete afat edhe me tej me vendim te themelueses se saj.

Neni 4

Veprimtaria e shoqerise do te zhvillohet ne perputhje me dispozitat e ketij statuti ,te aktit te themelimit dhe e mbeshtetur ne Legjislacionin Shqiptare ne fuqi si dhe ne aktet e tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te ketyre ligjeve .

Neni 5

Shoqeria vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper vete te gjitha te drejta dhe detyrimet . Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore dhe jashte kontraktore brenda kapitalit te saj .

Ortakja bart rrezikun e veprimtarise se shoqerise brenda nivelit te shumes se investuar .

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 6

SHOQERIA "KOPESHTI - LALA" SHPK ka per objekt veprimtarie :

Hapje kopshte private.



Neni 7

Kapitali themeltare i shoqerise eshte 100.000 Leke i formuar teresisht nga ORTAKE E VETME Teuta LALA.

Neni 8

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te paksohet sipas vendimit qe do te marrin Ortakja e vetme e shoqerise .Aktiviteti ne kete shoqeri nuk e pengon ortaken qe te kete te drejta pronesie jashte kesaj shoqerie .
Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e ortakes jashte kesaj shoqerie .

Neni 9

Shoqeria eshte pergjegjese vetem per kapitalin dhe mjetet qe disponon dhe asgje me teper.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 10

Shoqeria percakton fondet e saj, fondin themeltare dhe ate rezerve .Gjate ushtrimit te veprimtarise mund te caktohen edhe fonde te tjera .Fondi themeltare i shoqerise formohet nga mjetet e investuara nga ortake e shoqerise .
Shoqeria e shfrytezon kete fond per kryerjen e puneve te veprimtarise se saj si dhe per te mbuluar rreziqet pa shfrytezuar fondin reserve.Perberja dhe shumet e çdo fondi caktohen dhe kontrollohen nga ortakja e shoqerise .

Neni 11

Kur shoqeria pushon aktivitetin e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesa e mbetur e kapitalit dhe te ardhurat i mbeten teresisht ortakes se shoqerise.

Neni 12.

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqerise mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti. Ne fund te çdo periudhe ushtrimore administratori i shoqerise nxjerr bilancin kontabel me rezultatin Humbje – fitim si dhe perpilon raportet perkatese me shkrim. Bilanci vjetor duhet te paraqitet Brenda muajit mars te vitit pasardhes.

Neni 13



Te ardhurat neto, pas veçimit të fondeve të përmendura më sipër, i mbeten në përdorim shoqërisë.

Neni 14

Organet e shoqërisë janë:

1-Ortake e vetme.

2-Administratorja,

3-Komisioni i eksperteve kontabel. Detyrat e komisionit të eksperteve kontabel caktohen në përputhje me ligjin mbi kontabilitetin.

Administratore e shoqërisë është ortakja e vetme Teuta LALA.

Neni 15

Me Vendimet e Ortakes së vetme të shoqërisë realizohet i gjithë aktiviteti dhe veprimtaria e shoqërisë. Ajo përcakton drejtimet kryesore vendos bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, për pranimin në shoqëri të ortakëve të tjerë, të gjitha këto në bazë të ligjit për shoqëritë tregtare.

Neni 16

Ortakja e vetme lidh kontrata me persona fizikë dhe juridikë shtetërorë dhe privatë vendas dhe huaj si dhe vendos për drejtimet dhe aktivitetet e shoqërisë. Ajo vendos për fuqinë punëtore, për pagat e tyre duke lidhur me të kontrata në përputhje me ligjin.

Neni 17

Shoqëria mund të shpërndahet me likuidimin e saj. Në rastin e likuidimit të shoqërisë, emertimi i saj do të pasohet nga shenimi "shoqëri në likuidim të siper".


Neni 18

Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë për çfarëdo arsye. Për këtë ortakja e vetme e shoqërisë vendos për mënyrën e likuidimit të saj. Caktohet një ose disa Likuidator. Këta bëjnë kujdes që shoqëria të likujdojë me parë detyrimet që ajo u ka personave të tretë fizikë dhe juridikë.

Neni 19

Kapitali i shoqërisë kur vdes ortakja i mbetet sipas ligjit mbi trashëgiminë trashëgimtareve të tij ligjorë, shoqërine dhe trashëgojnë trashëgimtarët e saj ligjorë.

Neni 20



Administratorijska ka te drejte te emerije ekonomist e avokat si dhe tu japin te drejte personave te trete qe veprojne ne emer e per llogari te tij ,ne pershtatje te plote me ligjin mbi perfaqesimin.

Neni 21

Shoqeria quhet e regjistruar me marrjen e vendimit te Gjykates .

Neni 22

Shoqeria ka vulen me permbajtje "KOPESHTI - LALA" SHPK

Neni 23

Persa nuk eshte shkruar ne kete statut i referohet plotesimeve nga vendimet e Ortakes se vetme te shoqerise si dhe ligjeve per shoqerite tregtare.

Neni 24

Ky statut perpilohet ne kater kopjo, nje depozitohet ne noteri, nje ne zyren e regjistrit tregtare prane Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane, nje ne zyren e taksa tatimeve dhe nje ruhet ne dokumentacionin e shoqerise.

ORTAKE E VETME E SHOQERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR 11580 REP
NR — KOL

Teuta LALA




VERTETIM

Ne Tirane, sot, me dt 30/11 2005 para meje noteres u paraqit personalisht Teuta Lala e Bija e Petritit, lindur dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te ciles u sigurova nga dokumenti perkates qe mbante me vehte e cila deklaroi se sa me siper eshte shprehur vullneti i saj i lire e i plote .

Pasi nenshkruan rregullisht para meje noteres une e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE



NOTERE
Silvana Merko
Tel: 0682074214

